

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË
“Mediterraneo Holidays” sh.p.k.

Sot më 18.08.2022, në Durrës, shtetasit të mëposhtëm:

Nik Hadzovic, lindur në Kosovë, në 04.05.1976, me Nr. Pasaportës 016235120, lëshuar nga Ministria Serbe në datën 06.10.2021 dhe e vlefshme deri në datën 06.10.2031, me Nr. Personal 0405976930002, banues në Zvicër.

Bazuar në:

Kushtetutën e Shqipërisë;

Kodin Civil;

Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, kemi vendosur që, nëpërmjet këtij Akti Themelimi, të themelojmë shoqërinë

“Mediterraneo Holidays” sh.p.k.

NENI 1

Shoqëria themelohet me emrin **“Mediterraneo Holidays” sh.p.k.**, emër i cili do të pasqyrohet edhe në vulën zyrtare të shoqërisë. Shoqëria **“Mediterraneo Holidays” sh.p.k.** mund të përdorë emrin **“Mediterraneo Holidays” sh.p.k.** ose emrin tregtar **Mediterraneo Holidays**. Këtu e më poshtë në këtë Akt Themelimi, shoqëria **“Mediterraneo Holidays” sh.p.k.** do të referohet vetëm si shoqëria.

NENI 2

Selia e shoqërisë Lagjja Nr.4,Rruga Skenderbej, ZK 8514, nr.pasurie 2/106+1-2/2,Durrës.


NENI 3

3.1. Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Shqipërisë ose jashtë tij.

3.2. Me vendimarrjen e Asamblesë së Përgjithshme, shoqëria mund të themelojë degë ose zyra perfaqësimi, brenda ose jashtë territorit të Shqipërisë.

NENI 4

4.1. Kapitali themelues i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) lekë, që përfaqësohet nga 1 (një) kuotë.



4.2. Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

Nik Hadzovic është zotërues i 1 kuote, me 100% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlerë 100,000 lekë.

4.3. Kuotat janë nominale dhe nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë.

4.4. Çdo kuotë përfaqëson të drejtën për një votë.

NENI 5

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, në përputhje me objektin, për një periudhë kohore pa afat, që fillon nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 6

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me objektin e përcaktuar në këtë Akt Themelimi, bazuar në legjislacionin shqiptar si dhe në Statutin bashkëlidhur këtij Akt Themelimi.

NENI 7

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë, përfshirë dhe pa u limituar:

- Programimi dhe organizimi në fushën e udhetimeve turistike,hotelerise, te shitjes se biletave te te gjitha linjave tokesore,detare, ajrore te turizmit per shtetas vendas dhe te huaj, konsulence ligjore dhe teknike ne fushen e turizmit,agjent turizmi dentar,agjent turizmi kirurgji etj,sherbim taxi , tregtine brenda dhe jashte vendit (import - export),transport nderkombetar udhetaresh,,sherbimet online, kompania ka te drejte te kryeje cdo veprimtari tjeter qe nuk bie ne kundershtrim me sa me siper dhe qe konsiderohet e dobishme per te permbushur qellimin e veprimtarive te kompanise.

NENI 8

Shoqëria e fiton personalitetin e saj juridik dhe të drejtën për të ushtruar aktivitete si dhe për të marrë përsipër të drejta dhe detyrime, vetëm pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 9

Organi drejtues më i lartë i shoqërisë është **Asambleja e Përgjithshme**, e cila operon në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe merr vendime, përfshirë dhe pa u limituar, në përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë, amendimin e Statutit, emërimin dhe shkarkimin e administratorëve, likuidatorëve, Audituesve Ligjorë, mbikqyrjen e implementimit të politikave tregtare nga administratorët, themelimin e degëve të reja, miratimin e pasqyrave financiare dhe raportet e progresit të shoqërisë, zmadhimin dhe



zvogëlimin e kapitalit, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë si dhe çështje të tjera siç përcaktohen nga legjislacioni përkatës.

NENI 10

10.1. Administratori emërohet nga Asambleja e Përgjithshme.

10.2. Ne aktin e emërimit, përcaktohet edhe periudha e ushtrimit të funksionit, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.

NENI 11

Administratori i shoqërisë është **Z.Nik Hadzovic**, lindur në Kosovë, në 04.05.1976, me Nr. Pasaportës 016235120, lëshuar nga Ministria Serbe në datën 06.10.2021 dhe e vlefshme deri në datën 06.10.2031, me Nr. Personal 0405976930002, banues në Zvicër, i cili emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje.

NENI 12

Detajet në lidhje me menaxhimin e Kapitalit themelues, transferimin, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, menaxhimin administrativ të shoqërisë, balancat kontabël dhe financiare, falimentimin si dhe likuidimin etj., janë të përcaktuara qartësisht në Statutin e shoqërisë.

NENI 13

Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 kopje në gjuhën shqipe me të njëjtën përmbajtje dhe vlerë ligjore dhe, pasi u lexua, kuptua dhe u miratua në parim dhe nen për nen nga ortakët themelues të shoqërisë "**Mediterraneo Holidays**" sh.p.k., nënshkruhet dhe hyn në fuqi me miratimin dhe pranimin e depozitimit të tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË "Mediterraneo Holidays" sh.p.k.

MIRATIMI I KËTIJ AKT THEMELIMI NGA:

Z. Nik Hadzovic





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE DURRËS

NOTER ENTELA A. KARDHIQI
ADRESA NR.11, ALEKSANDER
GOGA, PALLAT 6 KATESH, ZK 8514,
NR. PAS 1/337-B, KATI PERDHE
TEL: 695113943

PROKURË E POSAÇME

Nr. repertori: 578

Nr. koleksioni: 288

Durres më 18/08/2022



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notërinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 1 fletë



A2022011240032516282



PROKURË E POSAÇME

Sot, më datë 18.08.2022, para meje Notere ENTELA A. KARDHIQI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durrës, NR.11, ALEKSANDER GOGA, PALLAT 6 KATESH, ZK 8514, NR. PAS 1/337-B, KATI PERDHE, u paraqit personalisht:

(I/E) PERFAQESUAR:

NIK HADŽOVIC, atësia Muharem, amësia Begije, shtetas Serb, lindur në PEC, REPUBLIKA SERBE dhe banues në adresë Pec, Pec Ruže Božidarevic 023, lindur më 04/05/1976, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Biometrike nr. 016235120 dhe nr. personal 0405976930002.

I cili me dëshirë të lirë, vullnet të plotë dhe të pa vesuar, kërkoi nga unë Noterja redaktimin e kësaj prokure të posaçme në bazë të neneve nr. 64, 70 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 62, neni 99 i ligjit 110/2018 "Për Noterinë", si më poshtë vijon:

"Unë i përfaqësuari i mësipërm, Emëroj si përfaqësues të posaçëm Ilda Kadrimi, atësia Ismail, amësia Dëshire, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në adresën Rajoni Nr.2, Rr. 'hajdar Demiri'; Nd. 037; H. 1; Ap. 13; Durrës; Durrës; 2003; Durrës, ie datëlindjes 07/09/1987, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038229221 dhe nr. personal I75907062H. Përfaqësueses time të posaçme i jap të gjitha tagret ligjore që në emër dhe për llogarinë time, edhe pa praninë time të kryej veprimet e poshtëshënuara:

Te me perfaqesoje ne te gjitha veprimet proceduriale dhe ligjore qe kane te bejne me nenshkrimin elektronik ne Akt Themelimin dhe Statutin e shoqerise MEDITERRANEO HOLIDAYS SHPK

Perfaqesuesesi ka te drejte te nenshkruaj ne emrin tim cdo dokument te nevojshem deri ne regjistrimin e shoqerise MEDITERRANEO HOLIDAYS SHPK

Gjithashtu e autorizoj qe te kryej edhe cdo veprim tjeter qe ka te beje me perfaqesimin para AKSHI si dhe cdo veprim ne sistemin online e-albania qe nuk eshte shprehur ne kete prokure por qe eshte i nevojshem per realizimin e veprimeve te permendura me larte.

Kjo prokurë e posaçme është e vlefshme nga momenti i nënshkrimit të saj dhe për një kohë të pacaktuar, deri në mbarimin e saj, me të drejtën e revokimit të saj në çdo kohë. E/I përfaqësuar/a/i deklaroi se: "Të gjitha veprimet e kryera nga përfaqësuesi im i posaçëm brenda tagrave të përcaktuara në këtë prokurë, në mbështetje të të drejtave që më njeh legjislacioni në fuqi në shtetin Shqiptar, do ti konsideroj të drejta e të mirëqena, sikur të ishin kryer prej vetë meje".

Prokura e Posaçme, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të të përfaqësuarës, e cila e kuptoi përmbajtjen e saj dhe meqenëse shpreh vullnetin e saj të lirë e të plotë, u njoh dhe i kuptoi efektet e saj juridike, e nënshkroi atë rregullisht përpara meje Noteres.

Nik Hadzovic



A2022011240032516282

Kjo Prokurë e Posaçme u hartua në gjuhën Shqipe prej meje Noteres në 3 (tre) kopje, me vlera të njëjta juridike, mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të të përfaqësuarës. Njëra kopje vendoset në arshivën noteriale, kopjet e tjerë për të përfaqësuarin.

Unë Noterja, verifikova identitetin e të përfaqësuarës nëpërmjet dokumentit të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë të neni 62, neni 99 i ligjit 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij akti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

(I/E) PERFAQESUAR

NIK HADŽOVIC

Nik Hadzovic

NOTER

ENTELE A. KARDHIQI

[Signature]

[Signature]

